KËRKESË
Nr. 7364, datë 3.12.2014

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Zgjerimi i Rrugës së Elbasanit (Fakulteti Filologjik-Unaza e Madhe e Tiranës„ (objekte)". Subjekti kërkues i këtij objekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur, në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave, "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe përllogaritjes së masës së shpërblimit për pasuritë pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik" i ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës).

Ky publikim bëhet për pasurinë e llojit "objekt dhe truall".

Pronarët do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik").

Vlera totale e shpronësimit është 52 979 606 (pesëdhjetë e dy milionë e nëntëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e gjashtë) lekë.

MINISTRI I TRANSPORTIT DHE INFRASTRUTURËS
Edmond Haxhinasto

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës
Sektori i shpronësimeve

LISTA E PRONARËVE TË OBJEKTEVE QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR "ZGJERIMI I RRUGËS SË ELBASANIT" (FAKULTETI FILOLOGJIK-UNAZA E MADHE TIRANË, OBJEKTE), SHTESA

Nr.	Emri - atësia - mbiemri	Z.K.	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqe ndërtimi (m²)	Sipërfaqe trualli (m²)	Çmimi truallit (lek/m²)	Vlera e truallit	Vlera e objektit	Vlera totale (lekë)	Shënime
1	Subjekti ndërtues "MAREG" Investitori Pavlin Kalusha	8160	5//84	Objekt polifunksional	1289				30357710	30,357,710	Leje ndërtimi
2	Fatos Babo +bp.	8160	5//84	Truall		396	57126	22621896		22,621,896	Konfirmuar nga ZVRPP
	SHUMA TOTALE									**52,979,606**	